

VENDIM
Nr.27, datë 21.1.1997

PËR TË MËNJANUAR SHKALLËZIMIN E MËTEJSHËM TË PASOJAVE NGA
HUADHËNIA NË SKEMAT PIRAMIDALE

Me propozimin e Kryetarit të Këshillit të Ministrave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Të ngrihet Komisioni i posaçëm qeveritar, kryesuar nga z.Hasan Halili, Ministër pa Portofol, për të vlerësuar përmasat reale të fenomenit të huamarrjes në skemat piramidale, pasojat e tij dhe masat që duhen marrë në dobi të huadhënësve, duke synuar mosdëmtimin e mëtejshëm të tyre.

Në këtë Komision bëjnë pjesë anëtarë të qeverisë dhe ekspertë të administratës shtetërore.

2. Të përgatitet menjëherë kuadri ligjor i nevojshëm për ndalimin e huamarrjeve, bazuar në skemat piramidale.

3. Të hartohet sa më parë, mbi bazën e të dhënave të këtij Komisioni dhe të strukturave të tjera të shtetit shqiptar, ligji për shpërndarjen e depozitave në të holla dhe të pasurive të patundshme të ngrira në interes të huadhënësve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi